



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 korrik 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(1), (2), dhe (4)(c) dhe (d), 22(6) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9(5)(a), 104(5) dhe 116 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 qershor 2025, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër të rishikuar për caktimin e afateve ("Urdhri i Rishikuar për Caktimin e Afateve"),¹ ku urdhëroi, ndër të tjera, që secili prej ekipeve të Mbrojtjes për të katër të akuzuarit (bashkërisht, "Mbrojtja"):

- (i) të njoftojë Trupin Gjykues në përputhje me rregullën 119(1) nëse synon të paraqesë prova të Mbrojtjes, në rast se Trupi Gjykues rrëzon tërësisht ose pjesërisht mocionin e përbashkët sipas rregullës 130 ("Mocioni sipas Rregullës 130"),² jo më vonë se të mërkurën, 16 korrik 2025; dhe
- (ii) të dorëzojë, jo më vonë se të hënën, 21 korrik 2025, listën e dëshmitarëve ("lista e dëshmitarëve") që synon të thërrasë dhe listën e provave materiale të propozuara ("lista e provave materiale") që synon të paraqesë në përputhje me rregullën 119(2), si dhe të përmbushë kriteret e tjera të rregullës 119(2), në rast se Trupi Gjykues rrëzon tërësisht ose pjesërisht Mocionin sipas Rregullës 130.³

Në Urdhrin e Rishikuar për Caktimin e Afateve, Trupi Gjykues gjithashtu i informoi palët dhe pjesëmarrësit se, në rast se rrëzon tërësisht ose pjesërisht Mocionin sipas Rregullës 130, Trupi Gjykues synon të mbajë konferencën

¹ F03232, Trupi Gjykues, *Urdhër i Rishikuar për Caktimin e Afateve*, 5 qershor 2025.

² F03256, Mbrojtja, *Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes sipas Rregullës 130*, 12 qershor 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

³ Urdhri i Rishikuar për Caktimin e Afateve, para. 10, 12(e).

përgatitore për Mbrojtjen sipas rregullës 119(3) gjatë javës që fillon të hënën, 21 korrik 2025.⁴

2. Më 13 qershor 2025, Mbrojtja dorëzoi kërkesë të përbashkët për ndryshimin e afateve të rishikuara ("Kërkesa e Mbrojtjes").⁵

3. Më 23 qershor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigjja e ZPS-së").⁶

4. Më 27 qershor 2025, Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjen e përbashkët ("Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes").⁷

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja kërkon ndryshimin e afateve të përcaktuara në Urdhrin e Rishikuar për Caktimin e Afateve në mënyrë që: (i) të dorëzojë listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale deri të hënën, 18 gusht 2025; dhe (ii) konferenca përgatitore për Mbrojtjen të mbahet gjatë javës që fillon të hënën, 18 gusht 2025.⁸ Mbrojtja parashton se Kërkesa është bërë në kohë,⁹ dhe se ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e afateve sipas rregullës 9(5)(a), duke pasur parasysh: (i) vëllimin dhe kuadrin e kufizuar të provave të mundshme të Mbrojtjes;¹⁰ (ii) kohën që i duhet Mbrojtjes për ndërmarrjen e hapave proceduralë të nevojshëm, përfshirë marrjen e autorizimeve nga dhënësit e informacionit sipas rregullës 107;¹¹ (iii) pamundësinë e Mbrojtjes për të përmbushur detyrimet e

⁴ Urdhri i Rishikuar për Caktimin e Afateve, para. 11, 12(f).

⁵ F03258, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve*, 13 qershor 2025.

⁶ F03283, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve dhe Çështje lidhur me Të*, 23 qershor 2025.

⁷ F03293, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve dhe Çështje lidhur me Të (F03283)*, 27 qershor 2025.

⁸ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 2, 12.

⁹ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 4.

¹⁰ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3, 5.

¹¹ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3, 6.

parashikuara në rregullën 119 brenda afateve të propozuara;¹² (iv) mungesën e kohës dhe mjeteve e mundësive të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes për shkak të kërkesave konkurruese;¹³ dhe (v) faktin që palët dhe pjesëmarrësit nuk u dëgjuan para se Trupi Gjykses të lëshonte Urdhrin e Rishikuar për Caktimin e Afateve.¹⁴ Mbrojtja parashtroon gjithashtu se: (i) parimi i shpejtësisë nuk mund të përdoret në dëm të Mbrojtjes apo drejtësisë së procesit;¹⁵ dhe (ii) ndryshimi i kërkuar i afateve është i arsyeshëm dhe i kufizuar dhe nuk do t'i shkaktonte dëm palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë.¹⁶

6. ZPS-ja përgjigjet se: (i) duke pasur parasysh se autorizimet sipas rregullës 107 janë të vetmet aspekte konkrete të pazgjidhura që identifikohen specifikisht në Kërkesë, Mbrojtjes duhet t'i kërkohej të dorëzojë listën paraprake të dëshmitarëve dhe provave materiale për të gjitha përmbajtjet që nuk janë objekt i rregullës 107 brenda afatit fillestar të 21 korrikut 2025; dhe (ii) më pas, lista e plotë dhe përfundimtare e dëshmitarëve dhe provave materiale mund të dorëzohet deri më 18 gusht 2025 dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen të mbahet atë javë siç u kërkuar.¹⁷ ZPS-ja paraqet kërkesa të mëtejshme ("Kërkesat e Mëtejshme të ZPS-së"), ku kërkon që Trupi Gjykses të urdhërojë Mbrojtjen që: (i) të përmbushë, deri më 21 korrik 2025, detyrimet e saj për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 104(5) në lidhje me çdo dëshmitar dhe provë materiale që nuk varet nga marrja e autorizimeve nga dhënësit e informacionit sipas rregullës 107; (ii) të përfundojë nxjerrjen e materialit të mbetur sipas rregullës 104(5) në mënyrë progresive dhe jo më vonë se 18 gusht 2025; (iii) të dorëzojë, deri më 18 gusht 2025, informacionin e përcaktuar në paragrafin 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit¹⁸, bashkë me

¹² Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3, 7.

¹³ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3, 8-9.

¹⁴ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3.

¹⁵ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 10.

¹⁶ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 11.

¹⁷ Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 5, 7-8, 11.

¹⁸ F01226/A01, Trupi Gjykses, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023.

listat e plota e përfundimtare të dëshmitarëve dhe provave materiale; si dhe (iv) të parashtrojë, në mënyrë progresive dhe më së voni deri më 22 gusht 2025, çdo kërkesë të nevojshme lidhur me dëshmitarët që Mbrojtja synon të thërrasë për të dëshmuar para Trupit Gjykues, përfshirë kërkesat për masa mbrojtëse në sallën e gjyqit, për masa sipas rregullës 107 në përputhje me kushtet e vendosura nga dhënësi i informacionit, si dhe kërkesat sipas rregullës 154.¹⁹

7. Mbrojtja kundërpërgjigjet se: (i) Përgjigjja shtrembëron ose shpërfill parashtrimet në Kërkesë dhe fokusohet kryesisht në aspekte të parëndësishme ose që nuk kanë lidhje me të; dhe se (ii) Kërkesa përmban arsye mjaftueshëm të vlefshme për ndryshimin e propozuar të afateve të përcaktuara në Urdhrin e Rishikuar për Caktimin e Afateve dhe duhet të miratohet në bazë të rregullës 9(5)(a).²⁰ Mbrojtja gjithashtu parashtron se: (i) Kërkesat e Mëtejshme të ZPS-së janë tërësisht të papërshtatshme dhe, në thelb, uzurpojnë funksionet e Trupit Gjykues;²¹ dhe (ii) Mbrojtjes nuk duhet t'i kërkohet të dorëzojë listë paraprake të dëshmitarëve dhe të provave materiale deri më 21 korrik 2025, sikurse propozon ZPS-ja.²²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në bazë të rregullës 9(5)(a), Trupi Gjykues, *proprio motu* ose pasi t'i tregohen arsye të vlefshme, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej Trupit Gjykues.

9. Në bazë të rregullës 104(5), nëse vendos të paraqesë prova, brenda afatit të caktuar nga Trupi Gjykues dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara hapjes së çështjes së vet, Mbrojtja: (i) i lejon ZPS-së të këqyrë dhe të bëjë kopje të

¹⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1-2, 9-11.

²⁰ Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 1. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, para. 3-6.

²¹ Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 8. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, para. 7, 9-10.

²² Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 11.

çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Mbrojtjes, që Mbrojtja synon t'i përdorë si prova në gjykim; (ii) i jep ZPS-së deklaratat, nëse ka, të të gjithë dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, si dhe të gjitha deklaratat e marra që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) i jep ZPS-së provat materiale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim.

10. Në bazë të rregullës 116, Trupi Gjykses merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit, si dhe mund të këshillohet me palët për tema që kanë lidhje me çështjen gjyqësore duke organizuar konferenca për ecurinë e çështjes gjyqësore që i gjykon të nevojshme.

IV. DISKUTIM

A. KËRKESA E MBROJTJES

11. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se ka përgjegjësinë të sigurojë që shqyrtimi gjyqësor të jetë jo vetëm i drejtë, por edhe i shpejtë, dhe që gjatë procesit gjyqësor të mos shkaktohen vonesa të panevojshme.²³ Në kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes se palët dhe pjesëmarrësit nuk u dëgjuan lidhur me këtë aspekt,²⁴ Trupi Gjykses vë në dukje se organizoi disa konferenca mbi ecurinë e çështjes me palët dhe pjesëmarrësit për të diskutuar mbylljen e paraqitjes së provave nga ZPS-ja, hapat proceduralë të mëpasshëm dhe afatet lidhur me paraqitjen e provave nga Mbrojtësi i Viktimave, si dhe paraqitjen e provave nga Mbrojtja.²⁵ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se i ka shqyrtuar me kujdes parashtrimet e bëra gjatë atyre konferencave mbi ecurinë e çështjes në caktimin e afateve përkatëse.

²³ *Shih* nenin 40(2); rregullën 116(1).

²⁴ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3.

²⁵ *Shih* Transkriptin e seancës, 1 tetor 2024, f. 20534-20576; Transkripti i seancës, 19 shkurt 2025, f. 25435-25472; Transkripti i seancës, 23 prill 2025, f. 26129-26189.

12. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se e lëshoi Urdhrin e Rishikuar për Caktimin e Afateve më 5 qershor 2025, d.m.th. më shumë se gjashtë javë përpara afateve të përcaktuara në këtë urdhër lidhur me Mbrojtjen. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se ZPS-ja e përfundoi paraqitjen e provave të saj më 15 prill 2025,²⁶ d.m.th. më shumë se tre muaj përpara atyre afateve. Trupi Gjykses është i mendimit se Mbrojtjes iu dha kohë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të respektuar dispozitat e rregullës 119(2).²⁷ Fakti që provat e mundshme të Mbrojtjes janë të kufizuara sa i përket vëllimit dhe kuadrit të tyre, nuk përbën arsye të vlefshme për zgjatjen e afateve që kërkon Mbrojtja për dorëzimin e listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale.²⁸ Në fakt, ai mbështet edhe më shumë sugjerimin se Mbrojtja duhet të jetë në gjendje të dorëzojë informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar tashmë. Kjo konfirmohet edhe nga Kërkesa e Mbrojtjes, ku përmendet numri i përafërt i dëshmitarëve që të paktën dy ekipe të Mbrojtjes planifikojnë të thërrasin, si dhe mënyra se si do ta japin dëshminë ata dëshmitarë.

13. Së fundi, megjithëse Mbrojtja ka të drejtë se e drejta themelore për gjykim pa vonesa të panevojshme, siç garantohet nga Ligji dhe instrumentet e të drejtave të njeriut, i takon të akuzuarit,²⁹ ekziston një pritshmëri më e gjerë me rëndësi për zhvillimin e shpejtë të procesit penal.³⁰ Në veçanti, prej Trupit Gjykses pritet që të sigurojë proces të drejtë për të akuzuarit, por edhe të shmangë vonesat e panevojshme që mund të ndikojnë në të drejtat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira,³¹ si dhe në interesat e drejtësisë, për të cilat Trupi Gjykses është

²⁶ F03121, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 129*, 15 prill 2025.

²⁷ *Contra* Kërkesa e Mbrojtjes, para. 10.

²⁸ *Contra* Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3, 5.

²⁹ *Shih* Kërkesën e Mbrojtjes, para. 10.

³⁰ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-T, Trial Chamber I Section A, [Decision on Motion of Accused Naletilić for a Trial Schedule which Incorporates Reasonable Breaks](#), 3 April 2002, p. 3.

³¹ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts and for Admission of Written Statements of Witnesses Pursuant to Rule 92bis](#), 28 February 2003, para. 11. *Shih gjithashtu* *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-A,

garantuesi.³² Rrjedhimisht, “të akuzuarit nuk janë të vetmit që kanë të drejtën e gjykimit të shpejtë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të heqin dorë prej saj”.³³

14. Në lidhje me parashtrimet e Mbrojtjes sa i përket kohës së nevojshme për marrjen e autorizimeve nga dhënësit e informacionit sipas rregullës 107,³⁴ Trupi Gjykues është i mendimit se, për sa kohë që Mbrojtja e dinte se marrja e autorizimeve ishte e domosdoshme, prej saj pritej dhe duhej ta kishte nisur procesin e marrjes së autorizimeve, përmes ushtrimit të zellit të duhur, që kur arriti në përfundimin se dëshironte ta përdorte atë material në gjykim. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues vëren se informacioni që duhet të dorëzojë Mbrojtja sipas rregullës 119(2) duhet t’i mundësojë Trupit Gjykues, si edhe palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë që të përgatiten në mënyrë të përshtatshme dhe efektive për provat që do të paraqesë secili ekip i Mbrojtjes.

15. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se nuk ekziston arsye e vlefshme se pse dorëzimi i listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale të Mbrojtjes duhet të presë përfundimin e procesit të marrjes së autorizimeve nga dhënësit e informacionit sipas rregullës 107. Çdo dokument për të cilin pritet ende autorizimi i dhënësit të informacionit sipas rregullës 107, si dhe cilido dëshmitar që lidhet me të, mund të identifikohet në listën e provave materiale dhe në listën e dëshmitarëve që do të dorëzohen brenda afatit të urdhëruar, me shënimin se ende nuk është marrë autorizimi nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107. Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje se sipas rregullës 119(5), pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, Trupi Gjykues mund ta lejojë Mbrojtjen të

Appeals Chamber, [Decision on Second Motions to Extend Time for Filing Appellant’s Briefs](#), 2 July 2001, para. 12-14.

³² *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-A, Appeals Chamber, [Decision on Motions to Extend Time for Filing Appellant’s Briefs, 11 May 2001](#), para. 17. *Shih gjithashtu* ECCC, *Prosecutor v. Nuon Chea et al.*, 002/19-09-2007-ECCC-OCIJ, [Order Issuing Warnings under Rule 38](#), 25 February 2010, para. 13; ICTR, *Prosecutor v. Bagosora*, ICTR-98-41-T, Trial Chamber I, [Judgement and Sentence](#), 18 December 2008, para. 82.

³³ ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al*, IT-04-74-T, Trial Chamber III, [Decision on Adoption of News Measures to Bring the Trial to an End within a Reasonable Time](#), 13 November 2006, para. 14.

³⁴ *Shih* Kërkesën e Mbrojtjes, para. 3, 6.

ndryshojë listën e dëshmitarëve ose provave materiale të saj kur nuk ka qenë në gjendje të bëjë njoftimin e plotë dhe të duhur për dëshmitarët dhe materialet që dëshiron të paraqesë në kuadër të provave të saj. Rrjedhimisht, nëse krijohet një situatë e tillë si rezultat i finalizimit të procesit të marrjes së autorizimeve sipas rregullës 107, ekipet e Mbrojtjes mund të dorëzojnë pa vonesë kërkesë për ndryshimin e listave të dëshmitarëve ose të provave materiale të tyre, siç ka qenë praktikë në këtë çështje deri më tani.

16. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses nuk është bindur se Mbrojtja ka demonstruar se nuk ka kohë as mjete e mundësi, apo se nuk është në gjendje, për çfarëdo arsye tjetër, të përmbushë detyrimet e parashikuara në rregullën 119(2) brenda afatit të urdhëruar.³⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme për të kërkuar ndryshimin e afatit për dorëzimin e listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale të Mbrojtjes.

17. Megjithatë, duke pasur parasysh përgatitjet aktuale të Mbrojtjes³⁶ dhe qëndrimin e ZPS-së në lidhje me këtë pikë³⁷, si dhe faktin që një shtyrje e shkurtër e konferencës përgatitore për Mbrojtjen mund të miratohet pa shkaktuar vonesa të panevojshme, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtja ka treguar arsye të vlefshme për të ndryshuar, pjesërisht, Urdhrin e Rishikuar për Caktimin e Afateve në mënyrë që konferenca përgatitore për Mbrojtjen të mund të mbahet menjëherë pas pushimit veror të Gjykatës. Kjo duhet t'i mundësojë Mbrojtjes të finalizojë të gjitha përgatitjet e nevojshme për paraqitjen efektive të provave të saj.

18. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses informon palët dhe pjesëmarrësit se Trupi Gjykses do ta mbajë konferencën përgatitore për Mbrojtjen në përputhje me rregullën 119(3) të martën, më 19 gusht 2025, në orën 10:00. Palët dhe pjesëmarrësit duhet të përgatiten për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes

³⁵ *Contra* Kërkesa e Mbrojtjes, para. 3, 8-9.

³⁶ *Shih* Kërkesën e Mbrojtjes, para. 7.

³⁷ Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 5, 8, 11.

në javën vijuese me paraqitjen e provave të të pandehurit të parë që përmendet në Aktakuzë, nëse ai zgjedh të paraqesë prova, dhe, nëse jo, me paraqitjen e provave të të pandehurit të radhës që përmendet në Aktakuzë dhe që zgjedh të paraqesë prova.

19. Gjithashtu, në përputhje me rregullën 116, dhe me synim garantimin e ndërmarrjes me zell të të gjitha hapave për kryerjen e të gjitha përgatitjeve të nevojshme për përfundimin e kësaj çështjeje gjyqësore, Trupi Gjykses do të mbajë një konferencë për ecurinë e çështjes të martën, më 22 korrik 2025, në orën 14:00. Palët dhe pjesëmarrësit duhet të njoftojnë Trupin Gjykses jo më vonë se të premten, 18 korrik 2025, ora 12:00, nëse mbrojtësit dhe të akuzuarit do të marrin pjesë me prani fizike apo përmes videokonferencës.

B. KËRKESAT E MËTEJSHME TË ZPS-SË

20. Megjithëse Trupi Gjykses pajtohet me Mbrojtjen se, në parim, përgjigjja nuk ka për synim të shërbejë si mjet për dorëzimin e një kërkesë të re,³⁸ Trupi Gjykses thekson se Kërkesat e Mëtejshme të ZPS-së kanë të bëjnë me afatet që burojnë nga Rregullorja ose urdhrat e Trupit Gjykses. Trupi Gjykses gjykon se është në interes të drejtësisë dhe të të gjithë personave në fjalë që këto aspekte të trajtohen sa më shpejt që të jetë e përshtatshme për t'u mundësuar personave në fjalë të përgatiten siç duhet. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është bindur se mjeti juridik i kërkuar përmes Kërkesave të Mëtejshme të ZPS-së “nuk ka lidhje” me këtë aspekt.³⁹

³⁸ *Shih* Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, para. 7 që i referohet F02421, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W00996, W02257, W02303, W04352, W04367, W04420, W04569, W04645, W04677, dhe W04732 sipas Rregullës 153, 2 korrik 2024, para. 23 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 korrik 2024, F02421/RED).

³⁹ *Contra* Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 7 që i referohet F02765, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W01234, W01338, W01743, W04423, W04570, W04696, W04812, W04859, dhe W04860 sipas Rregullës 153 dhe Mocionin e Mbrojtjes lidhur me të për Përrjashtimin e Provave, 11 dhjetor 2024, para. 48 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02765/RED).

Rrjedhimisht, hidhet poshtë kërkesa e Mbrojtjes për rrëzimin e menjëhershëm të Kërkesave të Mëtejshme të ZPS-së.

21. Në lidhje me themelësinë e Kërkesave të Mëtejshme të ZPS-së, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij më lart se Mbrojtja nuk ka demonstruar se nuk ka kohë as mjete e mundësi, apo se nuk është në gjendje, për çfarëdo arsye tjetër, të përmbushë detyrimet e parashikuara në rregullën 119(2) brenda afatit të urdhëruar.⁴⁰ Për të njëjtat arsye që përcaktohen më lart,⁴¹ dhe ndryshe nga kundërshtimet e Mbrojtjes,⁴² Trupi Gjykses është i mendimit se Mbrojtja është në gjendje të përmbushë edhe detyrimet e saj për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 104(5): (i) deri të hënën, 21 korrik 2025, për dëshmitarët dhe provat materiale që nuk varen nga marrja e autorizimeve nga dhënësit e informacionit sipas rregullës 107; dhe (ii) deri të hënën, 18 gusht 2025, për materialin e mbetur të rregullës 104(5). Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se, për të nxitur zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit, është me vend që Mbrojtjes t'i kërkohej të përmbushë detyrimet e njoftimit të përcaktuara në paragrafin 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit sa i përket paraqitjes së provave nga ZPS-ja, dhe të caktojë si afat për përmbushjen e këtij detyrimi të hënën, 18 gusht 2025.⁴³

22. Sa i përket kërkesës së ZPS-së për përcaktimin e një afati të vetëm përpara fillimit të paraqitjes së provave të Mbrojtjes, brenda të cilit secili ekip i Mbrojtjes të dorëzojë kërkesat në lidhje me dëshmitarët që synon të thërrasë për të dëshmuar para Trupit Gjykses,⁴⁴ Trupi Gjykses thekson se ZPS-së nuk iu caktua një afat i tillë gjatë paraqitjes së provave të saj.

23. Rrjedhimisht, në këtë fazë, Trupi Gjykses nuk e sheh me vend t'i caktojë një afat të tillë Mbrojtjes. Megjithatë, Mbrojtja inkurajohet fuqimisht të dorëzojë çdo

⁴⁰ *Shih më lart* para. 16.

⁴¹ *Shih më lart* para. 12-15.

⁴² *Shih* Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, para. 8-9.

⁴³ *Contra* Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 10.

⁴⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1(d), 10-11.

kërkesë të nevojshme lidhur me dëshmitarët që synon të thërrasë për të dëshmuar para Trupit Gjykses, përfshirë kërkesat për masa mbrojtëse në sallën e gjyqit, për masa sipas rregullës 107 në përputhje me kushtet e vendosura nga dhënësi i informacionit, dhe kërkesat sipas rregullës 154, pa vonesë dhe të paktën tre javë përpara datës kur parashikohet të japë dëshmi dëshmitari përkatës.

24. Në përputhje me nevojën për të garantuar përfundimin në kohë të paraqitjes së provave të tyre, Trupi Gjykses gjithashtu u kërkon ekipeve të Mbrojtjes të përgatiten për të dorëzuar sa më herët që të jetë e mundur mocionet sipas rregullës 153 dhe rregullës 155, për të shmangur vonesat e panevojshme dhe paraprakisht në kohë të mjaftueshme para përfundimit të paraqitjes së provave të ekipit përkatës të Mbrojtjes. Trupi Gjykses do të verifikojë gatishmërinë e Mbrojtjes për të respektuar sa më sipër në konferencën përgatitore për Mbrojtjen dhe, nëse është e nevojshme, do të lëshojë urdhra në lidhje me këtë.

25. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen: (i) të përmbushë, deri të hënën, 21 korrik 2025, detyrimet e saj për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 104(5) në lidhje me dëshmitarët dhe provat që nuk varen nga marrja e autorizimeve nga dhënësit të informacionit sipas rregullës 107; (ii) të përfundojë nxjerrjen e materialit të mbetur të rregullës 104(5) në mënyrë progresive dhe jo më vonë se të hënën, 18 gusht 2025; si dhe (iii) të dorëzojë informacionin e përcaktuar në paragrafin 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit deri të hënën, 18 gusht 2025.

26. Trupi Gjykses gjithashtu i inkurajon fuqimisht ekipet e Mbrojtjes që: (i) të dorëzojnë kërkesat e nevojshme lidhur me dëshmitarët që synojnë të thërrasin për të dëshmuar para Trupit Gjykses, përfshirë kërkesat për masa mbrojtëse në sallën e gjyqit, për masa sipas rregullës 107 në përputhje me kushtet e vendosura nga dhënësit e informacionit, si dhe kërkesat sipas rregullës 154, pa vonesë dhe të paktën tre javë përpara datës së parashikuar për dhënien e dëshmisë së dëshmitarit përkatës; si dhe (ii) të jenë të përgatitura për të dorëzuar, sa më herët që të jetë e mundur, mocionet sipas rregullës 153 dhe rregullës 155 për të

shmangur vonesat e panevojshme dhe paraprakisht në kohë të mjaftueshme para përfundimit të paraqitjes së provave të ekipit përkatës të Mbrojtjes.

V. VENDIM

27. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** pjesërisht Kërkesën;
- b) **PËRSËRIT** urdhrin e vet drejtuar Mbrojtjes që: (i) të njoftojë Trupin Gjykues në përputhje me rregullën 119(1) nëse synon të paraqesë prova të Mbrojtjes, jo më vonë se **të mërkurën, 16 korrik 2025**; dhe (ii) të dorëzojë listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale, si dhe informacionin e kërkuar prej rregullës 119(2)(a) dhe (b), jo më vonë se **të hënën, 21 korrik 2025**;
- c) **INFORMON** palët dhe pjesëmarrësit se Trupi Gjykues do të mbajë një konferencë për ecurinë e çështjes në përputhje me rregullën 116 **të martën, më 22 korrik 2025, në orën 14:00**, dhe **URDHËRON** palët dhe pjesëmarrësit të njoftojnë Trupin Gjykues jo më vonë se **të premten, 18 korrik 2025, në orën 12:00**, nëse mbrojtësit dhe të akuzuarit do të marrin pjesë me prani fizike apo përmes videokonferencës;
- d) **URDHËRON** Mbrojtjen: (i) të përmbushë, deri **të hënën, 21 korrik 2025**, detyrimet e saj për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 104(5) në lidhje me dëshmitarët dhe provat materiale që nuk varen nga marrja e autorizimeve nga dhënësit e informacionit sipas rregullës 107; (ii) të përfundojë nxjerrjen e materialit të mbetur të rregullës 104(5) në mënyrë progresive dhe jo më vonë se **të hënën, 18 gusht 2025**; dhe (iii) të dorëzojë informacionin e përcaktuar në paragrafin 74 të Urdhrit për Zhvillimin e Gjykimit deri **të hënën, 18 gusht 2025**; dhe

- e) **INFORMON** palët dhe pjesëmarrësit se Trupi Gjykues do ta mbajë konferencën përgatitore për Mbrojtjen sipas rregullës 119(3) **të martën, më 19 gusht 2025, në orën 10:00.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 2 korrik 2025

Në Hagë, Holandë.